



PROGRAMI I TRANSPARENCËS

I. HYRJE

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile.

Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimitarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës AMSHC ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. Autoriteti Publik do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimitarisë së punës së AMSHC-së, nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.amshc.gov.al si dhe në mjediset e pritjes së publikut. Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet. Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e AMSHC-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Skema e publikimit paraqitet nëpërmjet tabelës përmbledhëse të evidentuar në këtë program.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

II. PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi Transparencës së AMSHC-së janë:
"E drejta për informim" është e drejtë Kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa asnjë përjashtim.
2. Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: AMSHC-ja ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e AMSHC-së dhe përkatësisht: Ligji nr. 9887, datë datë. 10.03.2008 "Për mbrojtjen të dhënave personale" i ndryshuar, Ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.
5. Organ mbikëqyrës i procedurave të informimit publik është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
6. Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.
7. Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:
 - *i plotë;*
 - *i saktë;*
 - *i përditësuar;*
 - *i thjeshtë në konsultim;*
 - *i kuptueshëm;*
 - *lehtësisht i aksesueshëm;*
 - *i pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AMSHC vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.amshc.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Strukturën organizative të autoritetit publik;
- Tekstet e plota, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore, të kodeve të sjelljes, dokumente politikash, të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të tij dhe që prek publikun e gjerë;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;
- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit;
- Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;
- Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;
- Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

- Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura, shumën e kontraktuar, palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara, informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;
- Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, një përshkrim të kategorive dhe formave të ndihmës shoqërore, subvencioneve të dhëna nga autoriteti publik dhe të procedurave për t'i përfituar ato, informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh, çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik;
- Çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, procedura, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të AMSHC-së, një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë;
- AP-ja, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë;
- Aktet që përmbajnë rregulla, norma apo kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të individit, si dhe me efekt të drejtpërdrejtë për ta, bëhen publike me anë të afishimit apo postimit në faqen zyrtare të internetit, brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga AMSHC-ja.

Informacioni i publikuar sipas kësaj skeme, përditësohet sa herë ai ndryshon.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS SË AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Kategoritë e informacionit publik	Baza ligjore	Dokumenti / përmbajtja	Afati kohor për publikim	Mënyra e publikimit	Struktura përgjegjëse
Përshkrim i strukture organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik.	Neni 18 i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 769 datë 15.7.2009 (I Ndryshuar)	Struktura organizative e publikuar ne rregulloren e institucionit në linkun http://www.amshc.gov.al/web/doc/ligjore/Struktura-Organizative-AMSHC.pdf	Menjëherë pas zbardhjes së V.K.M- së.	Në faqen zyrtare, në menunë LEGJISLACION http://www.amshc.gov.al/web/doc/ligjore/Rregullore_e_AMSHC.pdf	Inspektori i Sektorit të Financës dhe Kontrollit të Brendshëm-njëkohësisht edhe Koordinator i të Drejtës për Informim, në bashkëpunim me Specialistin e IT-së
Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës.	Kreu III i Ligjit 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”	Linku http://www.amshc.gov.al/web/programi-transparences/Dokumente/119_2014 - Per te drejten e informimit.pdf Adresa postare: Rruga Frosina Plaku, Nr. 58, Ish Godina e Observatorit- Tiranë Adresa elektronike: info@amshc.gov.al	Pas miratimit të Programit të transparencës. Menjëherë në rast ndryshimesh.	Në faqen zyrtare www.amshc.gov.al	Koordinatori në bashkëpunim me Specialistin e IT-së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit.	Rregullorja e AMShC-së.	Adresa: Rruga "Frosina Plaku" Nr. 58, Kati II, Tiranë Orari i punës bazuar në V.K.M-në Nr. 511 «Për kohëzgjatjen e orarit të punës» (I Ndryshuar): Koordinatori për të drejtën e informimit është : z. Alkent Shehaj E- mail: alkent.shehaj@amshc.gov.al	Pas miratimit të urdhërit të Drejtorit Ekzekutiv për caktimin e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit.	Në faqen zyrtare të AMShC-së: http://www.amshc.gov.al/web/programi-transparences/	Specialisti i IT-së dhe Koordinatori për të Drejtën e Informimit
--	-------------------------	--	--	--	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime	Ligji 152/ 2013 “Për Nëpunësin Civil”; Ligji 9049 datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë; Ligji Nr. 9584 datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura Kushtetuese dhe Institucioneve të pavarura të krijuara me ligj”.	a. Ligji 152/2013 http://www.amshc.gov.al/web/programi-transparences/Dokumente/152_2013_-_Nepunesi_Civil.pdf b. Ligji 9049 http://www.amshc.gov.al/web/programi-transparences/Dokumente/9049_2003_-_Deklarimi_pasurive.pdf c. Ligji 9584 http://www.amshc.gov.al/web/programi-transparences/Dokumente/9584_2006_-_Pagat.pdf	Menjëherë pas botimit në fletoren zyrtare. E përhershme	Në faqen zyrtare: 1. <u>Kategoria e pagës dhe arsimimi për secilin pozicion në strukturën e AMSHC-së</u>	Këshilli i Ministrave, Bordi Mbikqyrës, Drejtori Ekzekutiv.
--	--	--	--	---	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit.	Ligji 10 093 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.	Raporte monitorimi dhe auditimi në linkun e faqes zyrtare, nën menunë RAPORTE	Menjëherë pas depozitimit në AMhC ose publikimit në faqen zyrtare të monitoruesve.	Në faqen zyrtare: 1. <u>Raport Auditimi nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, datë 10.6.2014</u> 2. <u>PLAN PUNE VJETORE – 2018 - Sektori i Financës dhe Kontrollit të Brendshëm</u> 3. <u>Plan Strategjik Pune 2018</u>	Sektori i Financës dhe i Kontrollit të Brendshëm, në bashkëpunim me Specialistin e Informimit, Publikimit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.
---	---	---	--	--	--



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit.	Ligji për Menaxhimin Buxhetor në Institucionet Publike	Ligji nr. 9936 datë 26.6.2008 « Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë »	Pas miratimit të ligjit të buxhetit.	Në faqen zyrtare: Raport mbi Ecurinë Financiare Buxhetore të AMSHC-së për vitin 2017: 1. 4-mujori e parë 2. 4-mujori e dytë 3. 4-mujori e tretë	Spektori i Financës dhe Kontrollit të Brendshëm, në bashkëpunim me specialistin e informimit, publikimit dhe teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.
--	--	---	--------------------------------------	---	---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Informacion për procedurat e prokurimit.	Ligji Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (I Ndryshuar).	Regjistri i Skanuar	Menjëherë pas dërgimit në APP.	Në faqen zyrtare: 1. Regjistri Parashikimeve (2018) 2. Regjistri Parashikimeve (2017) 3. Regjistri i Realizimit te Prokurimeve Publike (2017)	Sektori i Financës dhe Kontrollit të Brendshëm, në bashkëpunim me specialistin e informimit, publikimit dhe teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.
Informacion për shërbimet që autoriteti i jep publikut.	Ligji për të drejtën e informimit	Regjistri i njoftimeve.	Përditësohet periodikisht.	Përditësohet periodikisht faqja zyrtare. Gjithashtu në linkun: http://www.amshc.gov.al/web/veprimtari/ dhe http://www.amshc.gov.al/web/newsletter/	Sektori i Zhvillimit të Programeve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Paraqitja e mendimeve në hartimin e projekt- akteve	Manuali për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje	Në faqen zyrtare të KUVENDIT në linkun e mëposhtëm: http://www.parlament.al/web/Projekt_Manual_per_pjesemarrjen_e_publicut_ne_vendimarrje_17768_1.php	Menjêherë pas miratimit nga Kuvendi i Shqipërisë.	Në faqen zyrtare të AMShC-së www.amshc.gov.al	SAPGZHR SZGPBNK SFKB
Mbajtja e dokumentacionit/ eve nga AMSHC- ja	Ligji 10 093 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.	Relacione dhe Raporte	Sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi	Në faqen zyrtare të AMShC-së www.amshc.gov.al	Specialisti i Arkiv – Protokollit SAPGZHR SZGPBNK SFKB
Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit publik”.	Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit publik”.	Tabelë	Pas miratimit të programit të transparencës.	Në faqen zyrtare të AMShC-së: 1. Format Kerkese per Informacion 2. Regjistri i Kërkesave dhe Përgjigjeve	Koordinatori në bashkëpunim me Specialistin e Informimit, Publikimit, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh.	Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit publik”.	Vendime, Rekomandime, Urdhëra, Vendime, Manuale, Udhëzues, Opinione	Pas miratimit nga Bordi Mbikqyrës, Drejtori Ekzekutiv ose i deleguari i tij sipas rastit	Në faqen zyrtare, sipas kategorisë përkatëse	Specialisti i Arkiv – Protokollit SAPGZHR SZGPBNK SFKB
Informacione të tjera të dobishme	Ligji 10 093 “Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.	Ankesa Kërkesa	Pas miratimit nga Bordi Mbikqyrës, Drejtori Ekzekutiv ose i deleguari i tij sipas rastit	Në rrugën zyrtare postare ose elektronike.	Specialisti i Arkiv – Protokollit SAPGZHR SZGPBNK SFKB



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, AMSHC-ja vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.amshc.gov.al dhe në mjediset e pritjes së publikut, kategoritë e mësipërme, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i transparencës”.

VI. MONITORIMI

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e autoriteteve publike, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje të së drejtës së informimit.

Komisioneri bën rekomandime për autoritetet publike, lidhur me konceptimin dhe zbatimin e programeve institucionale të transparencës.